



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-SC-2024-02

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 janar 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Supreme:

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Gjykatëse Kristinë van den Vajngart

Gjykatës Daniel Fransen

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Salih Mustafës:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(d), 33(6) dhe 48(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullës 193 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës Supreme për të vendosur në lidhje me Mocionin Urgjent të Mustafës për Zgjatje të Afatit për të Dorëzuar Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ("Kërkesa për Zgjatje të Afatit").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I shqiptoi Aktgjykimin, me të cilin shpalli z. Salih Mustafa fajtor për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte.² Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.³
2. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi Versionin e Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, ku urdhëronte z. Mustafa të paguante 207.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar viktimave me krimet për të cilat u shpall fajtor.⁴
3. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Versionin e Redaktuar Publik të Aktgjykimit të Apelit, ku konfirmoi vendimet e fajësisë të z. Mustafa për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte, por miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa, kundër dënimit të tij.⁵ Si rrjedhojë, Paneli i Gjykatës së Apelit uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁶

¹ F00001, Mocion Urgjent i Mustafës për Zgjatje të Afatit për të Dorëzuar Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 15 janar 2024.

4. Më 3 janar 2024, Administratorja miratoi kërkesën e z. Mustafa për të zëvendësuar mbrojtësin e tij, z. Julius von Bone dhe caktoi znj. Venkatesvari Alagenda si mbrojtësen e tij të re.⁷

5. Më 15 janar 2024, z. Mustafa kërkoi që t'i miratohej një zgjatje me 180 ditë për të dorëzuar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nga 14 marsi 2024, që "ishte afati për z. Mustafa të dorëzonte [një] kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë", ose, si alternativë, zgjatje me 90 ditë nga lëshimi i përkthimit në shqipe i Aktgjykimit.⁸

6. Më 17 janar 2024, Prokurorja e Specializuar dorëzoi Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Mocionit Urgjent të Mustafës për Zgjatje të Afatit për të Dorëzuar Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë.⁹

III. CAKTIMI

Pas shqyrtimit të nenit 33(6) të Ligjit dhe kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON:

Gjykatësen Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse

Gjykatësen Kristinë van den Vajngart

Gjykatësin Daniel Fransen

² KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykimi, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe version i redaktuar publik më 8 qershor 2023.

³ Aktgjykimi, para. 831.

⁴ KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Urdhrit për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 6 prill 2023, para. 283.

⁵ KSC-CA-2023-02/F00038/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023, para. 484.

⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁷ Kërkesa për Zgjatje të Afatit, para. 13.

⁸ Kërkesa për Zgjatje të Afatit, para. 17, 29.

⁹ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Urgjent të Mustafës për Zgjatje të Afatit për të Dorëzuar Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 17 janar 2024.

në Panelin e Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me Kërkesën për Zgjatje të Afatit dhe çdo aspekt për mbrojtjen e ligjshmërisë, pasi të dorëzohet, apo çështje të tjera në lidhje me të.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E mërkurë, 17 janar 2024
Në Hagë,
Holandë